

**Nuk ka të ardhme pa gjenerata me të ardhme:
FATON H. BISLIMI, SHQIPTARI NGA GJILANI, DO TË
STUDIOJË NË SHKOLLEN POSTDIPLOMIKE TË QEVERISJES
JOHN F. KENNEDY NË UNIVERSITETIN E HARVARDIT, ATY KU
SHKOLLOHEN LIDERËT E ARDHSHËM TË BOTËS**

**Shkruan:
Elida Buçpapaj**

**Zurich, Zvicër
2 Maj 2005
*Botuar në Bota Sot***

Shumë njerzë të jetës akademike ndërkombëtare të cilët kanë arritur në majet e pozitave në profesionet e tyre vijnë nga Universitetet më të famshme në botë, dhe pa dyshim njëri prej këtyre, nga më të famshmet e më të fashmeve në botë, pa koment, është Universiteti i Harvardit në qytetin Kembrixh të shtetit Masaçusets të SHBA-ve.

Harvard ka po ashtu një sëri shkollash postdiplomike, dhe njëra prej më të njofurave nga këto shkolla është Shkolla Postdiplomike e Qeverisjes John F. Kennedy nga e cila kanë dalur një numër presidentësh të SHBA-ve, si dhe shumë personalitete të famshme botërore. Pra famën e Harvardit e kanë edhe studentët që laurohen në të. Në mesin e tyre që kanë arritur të pranohen në Harvard, fatmirësisht ka patur edhe disa shqiptarë, shumica e të cilëve vinin nga Shqipëria, por tani do të ketë edhe studentë nga Kosova.

Për të filluar studimet aty në Shtator 2005 është pranuar edhe i vetmi Kosovar këtë vit, i riu nga Gjilani, Faton H. Bislimi tani më një emër i njohur veçanërisht për lexuesit tanë përmes shkrimeve të tij në kombëtarën *Bota Sot*. Përpos pranimit në Shkollën Postdiplomike të Qeverisjes John F. Kennedy të Harvardit, Fatonit iu është ofruar edhe një nga çmimet më presitgjioze të shkollës në fjalë, çmimi “John F. Kennedy Fellowship” një nga bursat më të larta që do të ndihmojë në mënyrë të konsiderueshme pagesën prej mëse \$80,000 në vjet të shkollimit në këtë shkollë.

Faton Bislimi do të magjistrojë në shkenca politike, gjegjësisht në Administratë Publike dhe Zhvillim e Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Shkolla e Qeverisjes JFK e Harvardit më 2007, program ky dy vjeçar në të cilin janë pranuar vetëm 60 studentë nga mijëra aplikantë. Është mjaft i rëndësishëm të përmendet fakti se vetëm dy përqind nga 60 të pranuarit, pra vetëm një, e në këtë rast Fatoni, vijnë drejtpërdrejt në studime pasuniversitare në këtë program menjëherë pas përfundimit të universitetit, pasi pjesa tjetër, kanë mëse tri apo pesë vjetë përvojë pune profesionale në ndonjë organ qeveritar apo organizatë ndërkombëtare.

Mirëpo, siç është shprehur edhe znj. Carol Finney, Drejtoreshë e Programit të Studimeve Pasuniversitare për Administratë Publike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Shkollën e Qeverisjes John F Kennedy të Harvardit, sukseset e deritanishme të Fatonit si në sferën akademike ashtu edhe në atë politike e publicistike, si dhe dedikimi i tij për të kontribuar për Kosovën si një vend në zhvillim e sipër, kanë qenë disa nga faktorët që kanë kontribuar në të pranuarit e tij në Harvard. Është interesant fakti, se Harvardi për Fatonin do të shërbejë si një kthesë në jetën e tij, pasi ai nuk ka studijuar shkencë politike në universitet. Ai në Maj të këtij viti diplomon me nderimet më të larta akademike nga Universiteti Lutheran i Teksasit me një diplomë (Bachelor of Science) në Shkencë Kompjuterike dhe një (Bachelor of Arts) në Matematikë. Ndërsa në Shtator, ai do të ndryshoj drejtimin e studimeve nga shkencat ekzakte në ato shoqërore, dhe pas diplomimit nga Harvardi, Fatoni do të ketë dy diploma universitare në shkencë natyrore dhe një diplomë pasuniversitare në shkencë shoqërore, një kombinim majft i rrallë, por tepër i kërkuar nga punëdhënës të ndryshëm anekënd botës.

Përmes punës së tij këmngulëse, në një moshë fare të re, Faton Bislimi ka bërë që emri i tij të jetë i njohur për shumë shqiptarë anekënd botës, si dhe personalitete të ndryshme dhe aktivistë e liderë të rinjë ndërkombëtarë. Bislimi është themelues dhe kryetar i Asociacionit Ndërkombëtar i Studentëve Shqiptar me seli në New York. Ai, jo vetëm që ka nderuar shqiptarët me prezantimet e denja të bëra nëpër shumë forume ndërkombëtare, por ka krijuar një sër lidhjesh me institucione dhe personalitete ndërkombëtare.

Edhe pse në moshë mjaft të re, vetëm njëzetedy vjeçare, Faton Bislimi, ka qenë shqiptari i parë nga Kosova që arriti të sigurojë përfaqësimin e Kosovës në Samitin Botëror të Rinisë me seli në Bruksel, në dhjetorin e vitit 2003. Ai po ashtu me dinjitet ka përfaqësuar Kosovën edhe në Konferencën Ndërkombëtare të Liderëve të Rinjë në Pragë në korrik 2003 ku ishte nderuar edhe me çmimin e prezantimit më të mirë gjatë punimeve të konferencës. Po ashtu, edhe më herët, qysh më 2001, Bislimi kishte qenë kryesues i delegacionit të të rinjëve kosovarë pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Rinjë organizuar nga Universiteti i Harvardit.

Verën e kaluar, Bislimi ka shërbyer si Asistent për Çështje të Ballkanit në Komitetin për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kongresit të SHBA-ve në Washington, DC, ndërsa që nga Nëntori 2002 është edhe Koordinator për Çështje të Rinisë dhe Studentëve pranë Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane.

Puna dhe angazhimi serioz i ka siguruar Bislimit vend edhe në një nga konferencat më të rëndësishme në botë – Konferencën e 50-të Vjetore të Këshillit të Traktatit të Atlantikut që do mbahet në Romë të Italisë prej 30 Nëntorit deri më 4 Dhjetor 2004. Ky është takimi vjetor i Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Traktatit të Atlantikut Verior dhe tema qendrore e tij është “E Ardhmja e Sigurisë Evro-Atlantike”. Ftesa e bërë nga Fabrizio Lucioli, Sekretar i Përgjithshëm i Bordit të Drejtorëve të Komitetit Italian të Atlantikut njëherit edhe organizator i Asamblesë vjetore të rradhës, për pjesëmarrjen e Bislimit në një forum kaq prestigjioz jo vetëm që e nderon atë personalisht, por mbi të gjitha e nderon vendin dhe kombin që ai me aq dinjitet dhe krenari e përfaqëson. Të

ftuarit zakonisht janë burrështetas të zgjedhur dhe zyrtarë të lartë nëpër qeveri të ndryshme. Ftesa e bërë ndaj Bislimit për pjesëmarrje është nder i veçantë për Kosovën, dhe mburrje që Bislimi është shtetas kosovar, dhe përfaqëson Kosovën edhe aty ku liderët e saj për momentin mungojnë.

Si rezultat i arritjeve të tij dhe sukseseve të treguara në prezantimet e tij në shumë forume ndërkombëtare, Bislimit i ishte dhënë e pozita e anëtarit të Komitetit të Asociacionit të Liderëve të Rinjë Politik të Atlantikut gjatë verës së kaluar.

Gjithmonë i përkushtuar për çështjen kombëtare, Faton Bislimi asnjëherë nuk pushon duke punuar me dinjitet. Ai është i vetmi shqiptar nga Kosova që është ftuar të ligjerojë mbi sistemin e arsimit në Kosovë në Konferencën “Dilemat e Vendeve Postkomuniste” të organizuar nga Universiteti i Wolverhamptonit në Britaninë e Madhe që do të mbahet në fund të Qershorit 2005. Bislimi është ligjëruesi i vetëm që nuk ka titullin doktor shkence në këtë konferencë ndërkombëtare prestigjioze që zhvillohet nën patronatin e Mbretërisë së Britanisë së Madhe. Bislimi para dhjetra ekspertëve ndërkombëtarë dhe qindra pjesëmarrësve në këtë konferencë do të ligjerojë me temën “Arsimi Kualitativ—Çels për Ndërtimin e një Kombi Përparimtar.”

E pra Faton Bislimi në një kohë kaq të shkurtër ka arritur suksese kaq serioze, të cilat flasin për një të ardhme brilante për të, të cilën në bashkëkombasit e tij do të kemi fatin që ta ndjekim si dëshmitarë. Gazeta kombëtare Bota Sot e ka shoqëruar Faton Bislimin në arritjet e tij, si një përfaqësues dinjitoz i brezit të rinjë të kombit shqiptar, për dedikimin e tij ndaj çështjes kombëtare të cilën Fatoni e ka reflektur edhe si bashkëpunëtor i gazetës tonë. Faton Bislimi është një nga ata të rinj që i takon e ardhmja e shtetit të Kosovës, për të konsoliduar demokracinë. Sepse nuk ka të ardhme të një kombi pa gjenerata me të ardhme.

Autorja është Redaktore Përgjegjëse e të përditshmës “Bota Sot”

Ju lutem mos hezitoni që komentet tuaja në lidhje me këtë publikim t'i dërgoni përmes faqës sonë në internet (nën rubrikën “Komentet”). Komentet tuaja janë gjithëherë të mireseardhura.

The Bislimi Group
www.bislimi.org